

PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 31.07.2024
PRIMLJENO
Nr.Nn.Pt. 02/347



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja (s), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (h), të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr.28/15 qeshor 2008”, bazuar në nenin 11 paragrafi 11.1, nenit 23 paragrafi 23.7 shkronja (i), të Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441 datë: 14.09.2024, propozimit nr.01/878 datë: 24.07.2024 të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen dytë të jashtëzakonshme e mbajtur me datë: 29.07.2024 merr këtë:

VENDIM

**Për shpalljen “Qytetar Nderi” i Komunës së Malishevës,
z.David Carr**

1. **Z. David Carr**, anëtar i Këshillit në New York, i jepet titulli “Qytetar Nderi” i Komunës së Malishevës, me motivacion:

“Për kontributin dhe përkrahjen e jashtëzakonshme të Komitetit Shqiptar në New York të Shteteve të Bashkuara të Amerikës”

2. Ky fakt do të evidentohet në regjistrin e veçantë të qytetarëve të dekoruar nga Komuna e Malishevës, të cilin e mban Kuvendi Komunal dhe kryetari i Komunës.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Malishevës.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hynë në fuqi sipas nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar, me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, përkatësisht pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :
MAPL-së
Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi

